



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 677 Prot.

Roskovec, më 21.11 2018

VENDIM

NR 93. DATË 19.11 .2018

***“PËR MIRATIMIN E PAKETËS FISKALE PËR VITIN 2019”***

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”; të ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; të Ligjit nr.9920 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Këshilli i Bashkisë,

**VENDOSI :**

- Miratimin e Strukturës dhe nivelet e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2019 që janë paraqitur si më poshtë:



## KAPITULLI I – Taksat Vendore

### 1.1 Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël

Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8 000 000 (tetëmillion ) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

**Baza e taksës/tatimi :** Këstet e parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për vitin vijues, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) million lekë, llogariten në bazë të të dhënave të deklaratës tatimore të një viti më parë. Forma dhe përmbajtja e deklaratës tatimore vjetore përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave.

**Niveli i Tatimit:** Nivelet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogel paraqiten si mëposhtë :

Shkalla Tatimore	Njësia	Niveli ligjot I Tatimeve	
		Bashkia Roskovec	Njësitë e tjera
Me qarkullim vjetor nga 0-5000000 lekë	Lekë /vit	0	0
Me qarkullim vjetor nga 5000001-8000000 lekë	Lekë /vit	5% e fitimit	5% e fitimit

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës/tatimit: Drejtoria Rajonale Tatimore, në rolin e agentit tatimor, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

### 1.2 Taksa mbi pasurinë e paluajtshme

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të paluajtshme , në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari apo bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë të cilat nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.

Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:

- Taksa mbi tokën bujqësore
- Taksa mbi ndertesën
- Taksa mbi truallin



Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë( ndërtesë, tokë bujqësore, truall) përdoruesi i pasurisë bën një vetëdeklarim të sipërfaqes pranë bashkisë. Bashkia nëpërmjet komisionit të ngritur mund të vlerësojë sipërfaqen e taksueshme.

### **1.2.1 Taksë mbi ndërtesat**

**Baza e taksës:** Baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Këshilli i Ministrave, në bazë të vjetërsisë së ndërtesës, mund të specifikojë nënkategori përkatëse.

1. Çmimi për meter katror sipërfaqe ndërtimi që shfrytëzohen për banim/strehim në Bashkinë Roskovec është 30,000 leke/m<sup>2</sup> sic përcaktohet në VKM Nr.132, datë 7.3.2018
2. Çmimi për meter katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari tregtimi dhe shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve. Në këtë kategori përfshihen edhe ndërtesa tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhim, tregtim ose/edhe shërbime me pakicë.
3. Çmimi për meter katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.
4. Çmimi për meter katror sipërfaqe ndërtimi për parkim i hapur është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.
5. Çmimi për meter katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale si: prodhim, përpunim ose magazinim të mallrave industrial, duke përfshirë fabrikat, depot, magazinat dhe objektet e tjera të ngjashme, është 50 (pesëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse sipas qyteteve.
6. Çmimi për meter katror sipërfaqe ndërtimi që përdoren për bujqësi dhe blegtori, apo veprimtari mbështetëse, si grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale, është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, me përjashtim të përpunimit ushqimor.
7. Çmimi për meter katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për banim në njësitë administrative jashtë qytetit përkatës, të cilat ju bashkuan njësitëve të qeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit Nr. 115/2014, reduktohet 10 (dhjetë) për qind.
8. Për ndërtesat e privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore" i ndryshuar, çmimi për meter katror është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit sipas zonave të tabelës, vetëm në rastin e shitjes së parë.

**Niveli i taksës mbi ndërtesat:** Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si më poshtë:

- a) 0,05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;
- b) 0,2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;



c) 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

**Nënkategoritë e ndërtesave/njësive pronësore, që shfrytëzohen për banim/strehim, jepen si më poshtë:**

1. Ndërtesa, e cila u shërben njerëzve për nevoja themelore banimi, duke përfshirë shtëpitë, apartamentet, banesat dhe ndërtesat e ngjashme;
2. Garazhet e mbyllura;
3. Bodrumet;
4. Çdo ndërtesë tjetër e ngjashme, mbi apo nën tokë, që nuk përdoret apo shfrytëzohet për qëllime të tjera veç atij të banimit.

**“Ndërtesa të tjera” përfshihen:**

1. Ndërtesa për tregëti dhe shërbime
2. Parkim të mbuluar dhe bodrume
3. Parkim i hapur
4. Ndërtesa për veprimtari industriale si: prodhim, përpunim ose magazinim të mallrave industrial, duke përfshirë fabrikat, depot, magazinat dhe objektet e tjera të ngjashme
5. Ndërtesat që përdoren për bujqësi dhe blegtori, apo veprimtari mbështetëse, si grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale

**Detyrimi për pagesë:** Detyrimi për taksën mbi ndërtesën është vjetor. Zyra e të ardhurave kryen llogaritjen në bazë të sipërfaqes dhe vlerës së taksës sipas tabelës dhe klasifikimit më sipër.

Mbledhja e kesaj takse behet me agjent tatimore të përcaktuar nga NJQV.

**Përjashtohen nga pagesa për taksën e ndërtesës së banimit familjet:**

1	Me ndihme ekonomike	Po
2	Tetraplegjik, paraplegjik	Po
3	Te verberit	Po
4	Invalid pune dhe të luftës	Po
5	Te perndjekurit politik	Po
6	Veteranet e luftes	Po

Perjashtimi behet kur pefituesi eshte kryefamiljar dhe e verteton statusin me dokument ligjor. Ky perjashtim vlen kur tatimpaguesi nuk merret me aktivitet privat.

**Përjashtime:** Përjashtohen nga pagesa e taksës së ndërtesës:



- a) pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- d) banesat sociale në pronësi të bashkive;
- e) pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
- f) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- g) strukturat akomoduese "Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name";
- h) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që përfitojnë pension pleqërie ose pension social, që janë me banim në fshat ose qytet, kur familja përbëhet vetëm nga pensionistët;
- i) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- j) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore.

Detyrimi duhet të paguhet deri në 30 dhjetor.

### 1.2.2 Taksa mbi tokën bujqësore

Përkufizimi: "**Tokë bujqësore**" është toka e përcaktuar si e tillë në regjistrin e zyrave të regjistrimit të pasurisë.

Baza e taksës: Është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi apo në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës përcaktohet mbi bazën e dokumentave të pronësisë, formularit nr.6, aktit të pronësisë, çertifikatës së regjistrimit të tokës.

Niveli i taksës mbi tokën bujqësore paraqiten si më poshtë:

Kategorit mesatare të tokës bujqësore	Njësia	Niveli i taksës mbi tokën bujqësore			
		Bashkia	Kuman	Strum	Kurjan
I	Lekë/ha/vit	5600	5600	5600	5600
II	Lekë/m2/vit	4900	4900	4900	4900
III	Lekë/m2/vit	4200	4200	4200	4200
IV	Lekë/m2/vit	3600	3600	3600	3600
V	Lekë/m2/vit	3000	3000	3000	3000
VI	Lekë/m2/vit	2400	2400	2400	2400
VII	Lekë/m2/vit	1800	1800	1800	1800



Detyrimi për pagesë : Detyrimi mbi taksën e tokës bujqësore është vjetor. Detyrimi llogaritet nga zyra e taksave dhe shlyhet në bankat e nivelit të dytë ose Postën Shqiptare në bazë të një kontrate të lidhur me këtë të fundit.

❖ **Per taksën e tokës bujqësore të zbritet 30% e detyrimit të vitit 2019 , per arketimet e kryera deri me 30.06.2019.**

Per Fshatin Marinez banoret qe jane te pajisur ne baze te ligjit 7501 me toke bujqësore brenda zones industriale do te paguajne ½( nje te dyten) e detyrimit per kete toke . Kjo e vertetuar nga komisioni i posacem qe do te ngrihet.

### **Përjashtim :**

Përjashtohen nga taksa e tokës bujqësore:

- sipërfaqja e tokës bujqësore që mbillet me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.
- vetem per normen per fryme invalidet e punes.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës: Strukturat e ngarkuar për llogaritjen e taksës mbi tokën bujqësore, për të gjitha kategoritë, është zyra e të ardhurave pranë Bashkisë Roskovec.

Ngarkohet Drejtoria e Bujqësisë, për vlerësimin e kategorisë së tokës si dhe saktësimin dhe verifikimin e periudhës së mbjelljes me kultura drufrutore dhe vreshtari, per çdo fermer/fermë. Drejtoria e Bujqësisë pranë Bashkisë Roskovec ngarkohet për përcaktimin e sipërfaqes në pronësi sipas personave, duke pasqyruar ndryshime të herëpashershme dhe ia përcjell këtë informacion Zyrës së të Ardhurave për llogaritjen e detyrimit.

### **1.2.3 Taksa mbi truallin**

**Përkufizimi:** Truall është sipërfaqe toke, jo bujqësore, jo hapësire publike që ndodhet brenda vijës kufizuese të ndërtimit, e përcaktuar nëpërmjet dokumentave ligjore të planifikimi, e miratuar për të ndërtuar mbi të.

**Baza e taksës:** Është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit.

Niveli i taksës mbi truallin paraqitet si mëposhtë :

Taksa mbi truallin	Njesia	Niveli i taksës mbi truallin
Për qëllime banimi nga individët	Lekë/m2/vit	0.14
Për qëllim biznesi	Lekë/m2/vit	12



Detyrimi për pagesë: Detyrimi për taksën mbi-truallin është vjetor. Zyra e të ardhurave kryen llogaritjen në bazë të sipërfaqes dhe vlerës së taksës sipas tabelës dhe klasifikimit më sipër.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës :

Detyrimi për familjet dhe bizneset llogaritet nga Zyra e të Ardhurave dhe shlyhet pranë Posta sh.a ose në çdo bank të nivelit të dytë, brenda 20 prill të vitit fiskal për biznesin dhe deri në 30 dhjetor për familjarët.

Deri në paraqitjen e dokumentacionit të pronësisë ose vetdeklarimit të sipërfaqes së truallit, detyrimi vjetor referues i taksës së truallit për familjet llogaritet për një sipërfaqe prej 250 m<sup>2</sup>.

Deri në paraqitjen e dokumentacionit të pronësisë ose vetdeklarimit të sipërfaqes së truallit, detyrimi vjetor referues i sipërfaqes së truallit për bizneset llogaritet në bazë të sipërfaqes së ndërtesës së aktivitetit.

### **1.3 Niveli tregues i taksës së zënies së hapsires publike**

**Për Bashkinë e Roskovecit 60 lekë/m<sup>2</sup> në muaj**

Shënim: Për njësite administrative të tjera, niveli tregues i taksës është sa një e dyta e nivelit tregues përkatës.

### **1.4 Taksa e fjetjes në hotel**

**Baza e taksës:** Është numri i netëve të qëndruara në hotel për një person.

Niveli i taksës paraqitet si më poshtë:

Taksa e fjetjes në hotel	Njësia	Niveli i taksës së fjetjes në hotel
Hotel 4-5 yje	Lekë/natë qëndrimi /për person	105
Bujtine, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese	Lekë/natë qëndrimi /për person	35

**Detyrimi dhe kështet e pagimit:** Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia, për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel.

Detyrimi derdhet për bashkinë brenda datës 5 të muajit pasardhës nga subjekti përkatës.

**Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës:** Struktura për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel është Zyra e të Ardhurave.

### **1.5 Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja**



**Baza e taksës:** Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

Llojet e ndërtimeve dhe investimeve	Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë		
	Në % të çmimit të shitjes për m <sup>2</sup> ose e vlerës së preventivit	Bashkia Roskovec	Njësitë e tjera
Ndërtime për qëllime banimi apo njësi shërbimi të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industris apo për përdorim public.	4%- 8%	4%	4%

**Baza e taksës:** Vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së njërive të shërbimit apo ndërtesave për qëllime banimi. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, " Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave", që miratohet çdo vit.

Llojet e ndërtimeve dhe investimeve	Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë		
	Në % të vlerës së investimit	Bashkia Roskovec	Njësitë e tjera
Ndërtime të ndryshme nga ato të përcaktuara më sipër	1-3	2%	2%
Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare etj.	0.1 por jo me pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit	0.1	0.1
Ndërtimet e reja të cilat janë në proces legalizimi	0.5 e vlerës së investimit	0.5	0.5

**Baza e taksës :** Niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit.

Detyrimi i taksës i takon investitorit.

Përlllogaritja e detyrimit nga taksa do të bëhet, duke aplikuar përqindjen përkatëse sipas kategorisë, ndaj vlerës së investimit për sipërfaqen respektive.

Në rastet kur investitor është Bashkia, kjo taksë nuk aplikohet.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës: Struktura e ngarkuar për flogaritjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja është Drejtoria e Urbanistikës, e cila



përcjell informacionin tek Zyra e të Ardhurave. Të gjitha subjektet ndërtuese do të tërheqin lejen e ndërtimit pranë Bashkisë Roskovec, vetëm pasi të kenë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë.

Struktura për vjeljen e taksës është Zyra e të Ardhurave pranë Bashkisë Roskovec.

**Përjashtohen nga pagesa e kësaj takse:**

- a. investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese "Hotel/Resort me pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name".
- b. Përjashtohen nga pagesa e kësaj takse edhe investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si "agroturizëm", sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.

**1.6 Garanci financiare për subjektet fizike/juridike, kërkues i lejes për ndërtimin, riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit:**

Garancia financiare: Në mbështetje të pikës 10 të VKM-së Nr. 575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte", subjekt fizik/juridik, kërkues i lejes për ndërtimin, **kërkues i lejes për ndërtimin, riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit**, përpara marrjes së lejes së ndërtimit duhet të depozitojë një garanci financiare për llogari të NJQV-së, e cila nuk do të jetë më e vogël se 3 % e vlerës së strukturës së objektit dhe përcaktohet me vendim të këshillit të NJQV-së.

Njësitë e qeverisjes vendore, konkretisht Drejtoria e Urbanistikës, në dokumentacionin e lëshimit të lejes për projektin e ndërtimit, kërkues i lejes për ndërtimin, riparimin, restaurimin apo shembjes, përcaktojnë se personi fizik ose juridik, të cilit i është dhënë leja për realizimin e projektit, duhet të provojë me dokumentacionin e nevojshëm përmbushjen e kërkesave sipas VKM Nr.575, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e përfundimit të projektit të ndërtimit, riparimit, restaurimit apo prishjes së objektit, i cili krijon mbetje inerte.

Garancia financiare i kthehet subjektit fizik/juridik pa interes nga Bashkia, e cila ka lëshuar lejen e ndërtimit, pasi të provoj se mbetet inerte janë dorëzuar, sipas pikave 4,5 dhe 6, të VKM Nr. 575 në landfillin ose në venddepozitim të përkohshëm të përcaktuar nga Bashkia. Në rast të mospërmbushjes së kushteve të sipërpërmendura, Bashkia konfiskon garancinë financiare.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimit: Struktura e ngarkuar për llogaritjen e pagesës së garancisë financiare është Drejtoria e Urbanistikës. Struktura e ngarkuar për vjeljen e detyrimit është Zyra e të Ardhurave pranë Bashkisë Roskovec.

**1.7 Taksa e kalimit e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme**



**Baza e taksës** mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës përcaktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2%. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

Niveli i taksës: Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Kategoritë e ndërtesave	Njësia	Bashkia Roskovec
Ndërtesa banimi	Lekë/m <sup>2</sup>	100
Ndërtesa të tjera për tregëti dhe shërbime	Lekë/m <sup>2</sup>	300
Ndërtesa të tjera	Lekë/m <sup>2</sup>	200

**Detyrimi për pagesën:** Taksa paguhet nga personi, që kalon e drejta e pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Përfshihen nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme:

- a) Enti Kombëtar i Banesave, Ministria e Financave dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore;
- b) personat, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat";
- c) subjektet që dhurojnë pasuri të paluajtshme kur përfitues të drejtpërdrejtë janë:
  - i. institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore;
  - ii) bashkësitë fetare ose organizatat jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi. Në këto raste dhuruesi, pasi ka marrë vërtetimin nga këshilli bashkiak ose I për përjashtimin nga taksa, bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të dhuruar. Në çastin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesën që i takon agentit të taksave.

**Mënyra e mbledhjes:** Agjenti tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, e cila në rolin e agjentit të taksës përfiton 3 % të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdh për llogari të buxhetit perkatës të Bashkisë Roskovec, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës : Ngarkohet Zyra e të Ardhurave pranë Bashkisë të bëjë rakordimet dhe planifikimin e të ardhurave me ZVRPP.

### 1.8 Taksa vjetore e mjeteve të përdorura



**Baza e taksës:** Është lloji i mjetit të transportit rrugor

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës: Struktura për mbledhjen e kësaj takse është Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Bazuar në numrin e mjeteve të rregjistruara sipas njësive vendore, 25% të të ardhurave vjetore nga kjo taksë i kalon përkatësisht Bashkisë Roskovec në llogari të degës së thesarit.

### ***1.9 Të ardhura pjesore nga taksa e rentës minerare***

**Baza e taksës :** Janë burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka çdo person fizik apo juridik, në çastin kur ai shet produktin. Çdo person fizik apo juridik, që është i liçensuar dhe/ose vepron në industri minerare, sipas një marrëdhënie kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentën minerare për burimet natyrore që nxjerr nga nën toka. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin që ai shet produktin.

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës: Struktura e mbledhjes e kësaj takse është Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor. Degët e doganave në rrethe ngarkohen me arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit, (34%) e të ardhurave të realizuara nga kjo taksë i kalon përkatësisht Bashkisë Roskovec në degën e thesarit .

### ***1.10 Taksa e tabelës***

**Baza e taksës:** Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet që duhet të vendosin emërtimin e subjektit në pamje ballore të njësisë ku zhvillojnë veprimtarinë, në hapësira të tjera publike të lejuara ose private, qofshin këto të lëvizshme ose të palëvizshme dhe shërbejnë për qëllime identifikimi.

Vendosja e tabelës për qëllime identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet, me përjashtim të ambulanteve. Drejtoria e Urbanistikës harton planin për vendosjen e mundëshme të tabelave për qëllime reklamimi, të thjeshta dhe elektronike.



## TAKSA E TABELES

Nr.	LLOJET E TABELAVE	Nj/matëse	Bashkia Roskovec
I.	Tabela për qëllime identifikimi		
a.	Tabelë për qëllime identifikimi, deri në 2 (dy) metër katror, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose Brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoret për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe ose lloji I aktivitetit të kompanisë.	lekë/m2/vit	0
b.	Tabelë për qëllime identifikimi mbi 2 metër katror, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitetin biznesi dhe që nuk përdoret për të reklamuar bizneset e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe ose lloji I aktivitetit të kompanisë.	lekë/m2/vit	45 000
II.	Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe në përmasat e tabelave për orientim		
	-Tabela identifikuese	lekë/m2/vit	120
III.	Tabela për qëllime reklamimi e lëvizshme e palëvizshme		
	-e thjeshtë (me/pa ndriçim)	lekë/m2/vit	13 500
	-elektronike	lekë/m2/vit	27 000
IV.	-Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, papaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.		
	-të të gjitha llojeve dhe përmasave	lekë/m2/ditë	1000

**Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës :** Ngarkohet Zyra e të Ardhurave pranë Bashkisë Roskovec. Detyrimi për bizneset llogaritet nga Zyra e të Ardhurave dhe shlyhet pranë Posta sh.a ose në çdo bank të nivelit të dytë, brenda 20 prill të vitit fiskal për biznesin .



## KAPITULLI II : TARIFAT VENDORE

Ky kapitull trajton tarifat vendore në mënyrë nominale duke u nisur nga elementet :

- Llojit të shërbimit , baza e taksueshme , kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, kohë e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

### II.1 Tarifë Regjistrimi Biznesi

Tarifa e regjistrimit paguhet nga bizneset kur regjistrohen për herë të parë pranë Zyres së Tatim -Taksave.Subjekti qe ka me shume se dy vendodhje paguan vetem per adresen ku ka seline kryesore te aktivitetit. Taksapaguesi regjistron cdo vendodhje te biznesit prane Bashkisë Roskovec. Rregjistrimi per here te pare behet perpara se taksapaguesi te filloje aktivitetin e biznesit te tij.

Gjate ketij regjistrimi taksapaguesi detyrohet te jape informacionin e mëposhtëm:

- I. Ekstraktin e marr nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit
- II. Fotokopje të kartës së identitetit
- III. Adresën e Vendodhjes së biznesit
- IV. Llojin e biznesit qe kryen ne atë vendodhje

Çdo të dhënë ose dokument tjetër , që mund të përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financës:

Tarifë regjistrimi biznesi	Roskovec	Strum	Kuman	Kurjan
Sub.fizik vendas/huaj	12000 lekë	10000 lekë	10000 lekë	10000 lekë
Sub.juridik vendas/huaj	15000 lekë	15000 lekë	15000 lekë	15000 lekë
Ambulant	2000 lekë	2000 lekë	2000 lekë	2000 lekë

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës : Ngarkohet Zyra e të Ardhurave pranë Bashkisë Roskovec.



## II.2 Tarifa e Tregut

Lloji i Tarifave	Roskovec	Strum	Kuman	Kurjan
Shites mishi ne markato	600 lekë/vend	0	0	0
Zenie vendi per gjedhe	100 lekë/vend	0	0	0
Zenie vendi per shpende	10 lekë/vend	0	0	0
Zenie vendi per te imta	30 lekë/vend	0	0	0
Zenie vendi industriale	50 lekë/vend	0	0	0

## II.3 Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave

Përkufizimi : Tarifës së pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet , personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brënda territorit të Bashkisë Roskovec dhe njësisive të saj administrative. te cileve u ofrohet ky sherbim.

Niveli i tarifës së pastrimit : Kategoritë, nenkategoritë dhe nivelet treguese janë të shprehura si më poshtë:

Tabelë 1. Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave për familjet

FAMILJARET ( për familje )	Lekë /vit
Njësia Administrative Roskovec	1200
Njësia Administrative Strum	700
Njësia Administrative Kuman	700
Njësia Administrative Kurjan	700

### Përfshihen nga pagesa për tarifën e pastrimit familjet:

1	Me ndihme ekonomike	Po
2	Tetraplegjik, paraplegjik	Po
3	Te verberit	Po
4	Invalid pune dhe të luftës	Po
5	Te perndjekurit politik	Po
6	Veteranet e luftes	Po
7	Kryefamiljarë pensionistë pa persona madhorë në ngarkim (përveç bashkëshortit/bashkëshortes);	50%
8	Kryefamiljarët gra ( te ve ose te divorcuara)	50%

Perjashtimi bëhet kur pëfituesi është kryefamiljar dhe e vërteton statusin me dokument ligjor.



Tabela 2.

Nr	BIZNESET (sipas lloji të aktivitetit)	ROSKOVEC	STRUM	KUMAN	KURJAN
1.	Fruta - Perime	12 000	8 000	8 000	8 000
2.	Ushqimore e bulmetore	12 000	10 000	10 000	10 000
3.	Mish , Peshke	12 000	10 000	10 000	10 000
4.	Artikuj te ndryshem me pakice	10 000	8 000	8 000	8 000
5.	Market	15 000	10 000	10 000	10 000
6.	Supermarket	20 000	15 000	15 000	15 000
7.	Artikuj Industrial	15 000	10 000	10 000	10 000
8.	Gazeta & Kiosta	9 000	9 000	9 000	9 000
9.	Farmacit	12 000	12 000	12 000	12 000
10.	Klinike dentare	14 000	14 000	14 000	14 000
11.	BAR - BUFE				
a.	Subjekte 40 m2	11 000	7 000	7 000	7 000
b.	Subjekte 40 m2 - 100m2	13 000	9 000	9 000	9 000
c.	Subjekte 101 m2 - 200m2	15 000	15 000	15 000	15 000
d.	Restorant	23 000	23 000	23 000	23 000
12.	Byrktore ,Fast Food	10 000	10 000	10 000	10 000
13.	Berber	10 000	8 000	8 000	8 000
14.	Parukiere	10 000	8 000	8 000	8 000
15.	Lojra Fati	40 000	40 000	40 000	40 000
16.	Lojera elektronike per femije	10 000	7 000	7 000	7 000
17.	Agjensi sigurimesh	15 000	15 000	15 000	15 000
18.	Kompani ne fushen e komunikimeve elektronike	35 000	20 000	20 000	20 000
19.	Sherbime monetare (Banka)	80 000	40 000	40 000	40 000
20.	Zdrukthari	35 000	20 000	20 000	20 000
21.	Punime Durale	15 000	15 000	15 000	15 000
22.	Materiale.Ndertimi e Mermeri	35 000	20 000	20 000	20 000
23.	Prodhime Brumërash	40 000	20 000	20 000	20 000
24.	Elektroshtepiake	17 000	17 000	17 000	17 000
25.	Tregëtim Karburantesh ne Rruget Nacionale	60 000	60 000	60 000	60 000
26.	Tregetim karburantesh neper fshatera	-	30 000	30 000	30 000
27.	Përpunim Qumeshti	30 000	30 000	30 000	30 000
28.	Pikë Grumbullimi Fruta Perime	30 000	30 000	30 000	30 000
29.	Mulli i thjeshte	15 000	15 000	15 000	15 000

30.	Përpunim Drithi	30 000	30 000	30 000	30 000
31.	Fabrike Përpunim Ulliri	30 000	30 000	30 000	30 000
32.	Farmaci Bujqesore	12 000	12 000	12 000	12 000
33.	Parkime (24 ore)	10 000	10 000	10 000	10 000
34.	Mjete Bujqesore	6 000	6 000	6 000	6 000
35.	Riparime të ndryshme (elektronike)	9 000	7 000	7 000	7 000
36.	Bilardo,kalceto	18 000	15 000	15 000	15 000
37.	Rrobaqepesi	13 000	13 000	13 000	13 000
38.	Servise makinash	22 000	22 000	22 000	22 000
39.	Sherbime te ndryshem (makinash,motorcikleta , bicikleta)	12 000	10 000	10 000	10 000
40.	Servis makinash + varreze Makinash	40 000	40 000	40 000	40 000
41.	Transport udhëtarësh				
a.	Per taxi (4+1)	3 000	3 000	3 000	3 000
b.	Per taxi (8+1)	4 000	4 000	4 000	4 000
c.	Autobuza ( 9-30)	4 500	4 500	4 500	4 500
d.	Autobuza ( 30-50)	5 000	5 000	5 000	5 000
42.	Transport Malli				
a.	Mjete 1.51 - 3.5 ton	3 500	3 500	3 500	3 500
b.	3.51 - 8 ton	4 000	4 000	4 000	4 000
c.	8.1-14 ton	4 500	4 500	4 500	4 500
d.	mbi 14 ton	5 000	5 000	5 000	5 000
43	Subjekte Prodhimi me TVSH	50 000	30 000	30 000	30 000
44.	<b>Subjekte Ndërtim</b>				
	A)Subjekte ndertuese me selinë administrative	70 000			
	B)Subjekte ndertimi sipas investimit dhe kohezgjatjes se kantierit te ndertimit				
	Per vlera investim deri ne 5 000 000 leke	20 000			
	Per vlera investim deri ne 5 000 001 leke -15 000 000 leke	40 000			
	Per vlera investim deri ne 15 000 001 leke -25 000 000 leke	60 000			
	Per vlera investim deri ne 25 000 001 leke -50 000	80 000			





	000 leke				
	Per vlera investim deri ne 50 000 001 leke -100 000 000 leke	100 000			
	Per vlera investim deri ne 100 000 001 leke -200 000 000 leke	150 000			
45.	Shkolla Private	60 000			
46.	Njesi Sherbimi (kembim Valute)	13 000	11 000	11 000	11 000
47.	Fotograf	10 000	10 000	10 000	10 000
48.	Subjekte sherbimi me Tvsh	35 000	20 000	20 000	20 000
49.	Profesione të lira	10 000	7 000	7 000	7 000
50.	Internet	12 000	10 000	10 000	10 000
51.	Magazine	15 000	15 000	15 000	15 000
52.	Call Center	20 000	10 000	10 000	10 000
53.	Laborator	20 000	15 000	15 000	15 000
54.	Parkim Privat	20 000	20 000	20 000	20 000
55.	Institucione Shteterore	10 000			
56.	Sherbime te tjera monetare	40 000			

Baza e tarifës : Është në lekë sipas kategorive e cila duhet te mbulojë koston e sherbimit  
Detyrimi për pagesë : Detyrimi për tarifën e pastrimit është vjetor. Per familjaret detyrimi paguhet deri ne daten 30 dhjetor.

Per bizneset detyrimi paguhet brenda datës 20 prill. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 20 prill është 30 ditë pas lindjes së detyrimit.

Përjashtimet për kategoritë e ndryshme:

Përjashtimet	Niveli
Invalidet e punës, të verbërit , paraplegjikët dhe tetraplegjikët	0
Përfituesit e ndihmës ekonomike	0
Kryefamiljarë pensionistë pa persona madhorë në ngarkim (përveç bashkëshortit/ bashkëshortes);	50%
Kryefamiljarët gra ( te ve ose te divorcuro)	50%



Perjashtimi bëhet kur përfutuesi është kryefamiljar dhe e vërteton statusin me dokument ligjor. Struktura përgjegjëse për vjeljen e tarifës së pastrimit ,është Zyra e të ardhurave.

#### II.4 Tarifa e gjelbërimit

**Përkufizimi:** Tarifa e gjelbërimit paguhet nga bizneset vendas ose të huaj, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë brenda territorit të Bashkisë Roskovec.

Tarifë gjelberimi	Roskovec	Strum	Kuman	Kurjan
Për Familje	400	400	400	400
Per bizneset	1000	1000	1000	1000

Per familjaret detyrimi paguhet deri ne daten 30 dhjetor.

Per bizneset detyrimi paguhet brenda datës 20 prill. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 20 prill është 30 ditë pas lindjes së detyrimit.

Do te paguajne per kete sherbim te gjitha ato familje ne fshate apo qytet qe kane hapësira te gjelberta.

Përjashtimet për kategoritë e ndryshme:

Përjashtimet	Niveli
Invalidet e punës, të verbërit , paraplegjikët dhe tetraplegjikët	0
Përfutuesit e ndihmës ekonomike	0
Kryefamiljarë pensionistë pa persona madhorë në ngarkim (përveç bashkëshortit/ bashkëshortes);	50%
Kryefamiljarët gra ( te ve ose te divorcuara)	50%

Perjashtimi bëhet kur përfutuesi është kryefamiljar dhe e vërteton statusin me dokument ligjor. Struktura përgjegjëse për vjeljen e tarifës së pastrimit ,është Zyra e të ardhurave

#### II.5 Tarifa e ndriçimit

Përkufizimi : Tarifa e ndriçimit paguhet nga bizneset vendas dhe të huaj, personat fizik dhe juridikë, qe banojnë /janë rezident brenda territorit të Bashkisë Roskovec.

Kategoritë , nënkategoritë dhe nivelet treguese të tarifës së ndriçimit janë të shprehura si më poshtë:



Tarifë ndriçimi	Roskovec	Strum	Kuman	Kurjan
Për Familje	500	500	500	500
Per bizneset	1000	1000	1000	1000

Baza e tarifës :Është në lekë sipas kategorive e cila duhet te mbulojë koston e shërbimit.

Detyrimi për pagesë : Detyrimi për tarifën e ndriçimit është vjetor.

Per familjaret detyrimi paguhet deri ne daten 30 qershor. Per bizneset detyrimi paguhet brënda datës 20 prill. Afati i pageses për detyrimet e lindura pas datës 20 prill është 30 ditë pas lindjes së detyrimit.

Do te paguajne per kete shërbim te gjitha ato familje ne fshate apo qytet qe marin kete shërbim.

Përjashtimet për kategoritë e ndryshme:

Përjashtimet	Niveli
Invalidet e punes,të verbërit , paraplegjikët dhe tetraplegjikët	0
Përfituesit e ndihmes ekonomike	0
Kryefamiljarë pensionistë pa persona madhorë në ngarkim (përveç bashkëshortit/bashkëshortes);	50%
Kryefamiljaret gra ( te ve ose te divorcuara)	50%

Perjashtimi behet kur perfituesi eshte kryefamiljar dhe e verteton statusin me dokument ligjor.

Struktura përgjegjëse për vjeljen e tarifës:Struktura përgjegjëse për vjeljen e tarifës së ndriçimit ,është Zyra e të ardhurave.

## II.6. Tarifa të shërbimit veterinar

Tarifë kontrolli veterinar	Roskovec	Strum	Kuman	Kurjan
Për gjedhe	300 lekë/krerë	300 lekë/krerë	300 lekë/krerë	300 lekë/krerë
Për dërra	200 lekë/krerë	200 lekë/krerë	200 lekë/krerë	200 lekë/krerë
Për te imta	100 lekë/krerë	100 lekë/krerë	100 lekë/krerë	100 lekë/krerë
Për subjekte (dyqane mishi)	1000 lekë/vit	1000 lekë/vit	1000 lekë/vit	1000 lekë/vit
Thertore + Baxho	2000 lekë/vit	2000 lekë/vit	2000 lekë/vit	2000 lekë/vit

Struktura përgjegjëse për vjeljen e tarifës :



Veterinerët përcjellin informacion tek Zyra e-të Ardhurave.

Tarifat mbulohen nga subjektet që përfiton shërbimin.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së shërbimeve është Zyra e te Ardhurave.

### **II.7 Tarifa për shërbim ne fushën transportit të pasagjerëve dhe mallrave , dhënien e lejeve për ushtrim aktiviteti**

Niveli i tarifave sipas shkresës së Ministrisë Financave Nr.13786/1 Dt 20.01.2010 "Për tarifat e liçensimit transportit rrugor, te mallrave e udhetareve"

<b>Nr.</b>	<b>Tarifat e liçensimit të transportit të udhëtarëve</b>	<b>Njesi</b>	<b>Tarifa</b>
1	Licencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse te udhetareve	Lekë/5 vjet	75 000
2	Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse te udhetareve	Lekë/mjet/vit	1 500
3	Licencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetësë	Lekë/5 vjet	40 000
4	Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetësë	Lekë/nje/vit	1 000
5	Licencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetësë	Lekë/5 vjet	20 000
6	Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetësë	Lekë/mjet/vit	1 500
7	Liçencë për kryerje e shërbimeve te rregullta te specializura te udhetareve	Lekë/5 vjet	20 000
8	Çertifikatë për kryerje e shërbimeve te rregullta te specializura te udhetareve	Lekë/mjet/vit	1 500
9	Liçencë për kryerje e shërbimeve vajtje – ardhje ( lavjerrese) te udhetareve	Lekë/5 vjet	20 000
10	Çertifikatë për kryerje e shërbimeve vajtje – ardhje ( lavjerrese) te udhetareve	Lekë/mjet/vit	1 500
11	Çertifikatë për transport udhëtarësh per nevojat e veta	Lekë/mjet/vit	1 500
12	Liçensë për agjensi transporti udhëtarësh dhe taksi brënda vendit	Lekë/5 vjet	15 000
13	Liçence për transport udhëtarësh me taksi	Lekë/mjet/5 vjet	20 000
14	Tarife per autorizim te perkoheshem mujore	Lekë/muaj	2 000



Nr.	Tarifat e licensimit të transportit të mallrave	Njesi	Tarifa
1	Liçence për transport mallrash për të tretë dhe me qera brënda vendit	Lekë/5 vjet	40 000
2	Çertifikate për transport mallrash për të tretë dhe me qera brënda vendit	Lekë/kapacitet	100*
3	Çertifikate për transport mallrash për vete brënda vendit	Lekë/kapacitet	100*

**Shënim:** Për dublikatë me të njëjtën përmbajtje dhe afat vlefshmërie paguhet 30% e vlerës së plote. Për rastet e ndryshimeve në licence / çertifikate që kane të bëjnë me elementet e përdoruesit të mjetit, fushës së operimit etj, paguhet 30% e vlefës së plotë.

Vlera e dalë nga llogaritja e ton/kapacitet do të shumëzohet me pesë.

Liçensat përkatëse jepen me afat një, tre dhe pesë vjecar, subjekteve juridike ose fizike të licensuar si biznes transporti ose si biznes tjetër të cili i vihet në dispozicion mjeti. Tarifat mbulohen nga subjekti që përfiton shërbimin.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së shërbimeve është Zyra e të Ardhurave.

#### II.8.1 Tarifa e parkimit

Nr	Tarifa e parkimit	Roskovec	Strum	Kuman	Kurjan
	Transport udhëtarësh				
1	Per taxi (4+1)	4 000	4 000	4 000	4 000
2	Per taxi (8+1)	5 500	5 500	5 500	5 500
3	Autobuza ( 9-30)	6 000	6 000	6 000	6 000
4	Autobuza ( 30-50)	7 500	7 500	7 500	7 500
	Transport Malli				
1	Mjete 1.51 -3.5 ton	2 500	2 500	2 500	2 500
2	3.51 -8 ton	3 500	3 500	3 500	3 500
3	8.1-14 ton	4 500	4 500	4 500	4 500
4	mbi 14 ton	5 500	5 500	5 500	5 500

Struktura përgjegjëse për vjeljen e tarifës :

Tarifat mbulohen nga subjekti që përfiton shërbimin. Pagesa e tarifës së parkimit është

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së shërbimeve është Zyra e të Ardhurave.



PAKETA FISKALE 2019

## II.8.2. Tarifa e parkimit abone

Nr	Tarifa e parkimit	Roskovec	Strum	Kuman	Kurjan
1.	Per cdo vend parkimi autovetura 4+1 dhe 8+1	10 000	5 000	5 000	5 000
2.	Per cdo vend parkimi autobus ose kamion	20 000	10 000	10 000	10 000

- a) Parkimi abone I jepet subjektit fizik apo juridik vetem me leje per parkim abone te leshuar nga specialisti I transportit. Ne lejen e leshuar percaktohet Nr. I vendparkimeve dhe vendodhja e tyre.
- b) Leja e vendparkimit abone do te jete ne perputhje me dispozitat e qarkullimit rrugor
- c) Arketimi i tarifes per vendparkim abone behet nga zyra e Tatim- Taksave sipas percaktimeve ne lejen e leshuar per subjektin.

## II.9 Tarifa për License karburanti/lëndë djegësë / bombula gazi

Nr.	Emërtimi	Njësia	Miratohet/lekë
1	Pagese për dhënien dhe përsëritjen e licensave për stacionet e shitjes se karburanteve, gazit te lëngshëm të naftës për automjete dhe vajra lubrifikant është:	Licencë	1 000 000
2	Pagesa për dhenien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegësë për përdorim nga konsumatorët fundor është:	Licencë	100 000
3	Autorizim per hyrje – dalje per stacionet e shitjes se karburanteve. Nje vjecare	Autorizim	6 000

## II.10 Tarifa bilete për Pallatin e Kulturës

Nr	Emërtimi	Çmimi
1	Dhënie shfaqesh , filmash, koncerte	100 lekë/ vend
-	Për femijet nën 16 vjec	50 lekë/vend
-	Për intitucione ( shkolla, kopshte)	Papagesë
2	Takime dhe mbledhje të ndryshme	7 000 lekë/nje dite



## II.11 Tarifa të Urbanistikës

Nr.	Lloj i tarifave	Roskovec	Njësiti Administrative
1	Tarifë plan vendosje për ndërtesë	5000 lekë/planvendosje	5000 lekë/planvendosje
2	Tarifë shërbimi për aplikim leje ndërtimi	500 lekë/dokument	500 lekë/dokument
3	Tarifë terheqje e vendimit për leje ndërtimi	500 lekë/dokument	500 lekë/dokument
4	Tarifë Leje Zhvillimi për objekte me funksion banimi	1 000 lekë/dokument	1 000 lekë/dokument
5	Tarifë Leje Zhvillimi për objekte me funksion të ndryshëm	5 000 lekë/dokument	5 000 lekë/dokument
6	Tarifë për lëshim autorizimi të thjeshtë për kryerjen e punimeve që nuk kërkojnë leje	10 000lekë/ dokument	10 000lekë/ dokument
7	Deklarate paraprake për kryerje punimesh në objekt banimi	10 000lekë/ dokument	10 000lekë/ dokument
8	Deklarate paraprake për kryerje punimesh në objekt shërbimi	10 000lekë/ dokument	10 000lekë/ dokument
	Tarifë plan vendosje lidhje energjie elektrike	1 000 lekë/planvendosje	1 000 lekë/planvendosje
10	Tarifë shërbim topografik për planvendosje	1 500 lekë/planvendosje	1 500 lekë/planvendosje
11	Tarifë skrepi	2 500 lekë/h	2 500 lekë/h
12	Tarifë për Akt – Teknik për sa i përket masave të mbrojtjes nga zjarri	1000 lekë	1000 lekë

## Tarife për leje ushtrimi aktiviteti tej kohës normale të punës

Nr.	Lloj i aktivitetit	Roskovec	Njësiti Administrative
1	Lojra – fati dhe kazino	20 000 lekë/muaj	20 000 lekë/muaj
2	Karburante	10 000 lekë/muaj	10 000 lekë/muaj
3	Bar – restorante, diskoteka	10 000 lekë/muaj	10 000 lekë/muaj
4	Bar -Kafe	1 000 lekë/muaj	1 000 lekë/muaj



## 11.8 Tarifa të tjera

Nr.	Lloj I tarifave	Roskovec	Nj. Administrative
2	Tarife dhenie informacioni	20 leke/flete,per mbi 10(flete)A4 te kerkuara 50 leke/flete,per mbi 5(flete)A3 te kerkuara	
3	Vërtetim Pasurie	100 lekë/vërtetim	100 lekë/vërtetim
4	Konfirmim I formularit Nr.6	200 lekë/ dokument	200 lekë/ dokument
5	Tarifë Shërbimi për kryerjen e procedurës së kalimit të pronësisë të p.p te ndërtimeve deri 10.08.1991 si dhe të truallit funksional	150 lekë/m2	150 lekë/m2
6	Tarifë për shpenzime varrimi (të rritur)	5 000 leke	5 000 leke
7	Tarifë për shpenzime varrimi (të mitur)	2 000 leke	2 000 leke
8	Tarifë kullotje bageti me qera		5 000 lekë
9	Tarifë gjuetie në pyje dhe kullota	1 000lekë	1 000lekë
10	Tarifë për grumbullimin e boceve te pishes		500 lekë/it
11	Tarife per leje peshkimi dhe gjueti	2000 leke/vit	2000 leke/vit
12	Tarifë për grumbullimin e herbave te ndryshme		2000 leke/vit
13	Ujitje e tokave me vetërrjedhje nga rezervuari Kurjan	400 lekë/dy per cdo ujitje	
14	Ujitje e tokave me ngritje mekanike nga vetëfermeri nga kanali kullues Kurjan	200 lekë/dy per cdo ujitje	
15	Ujitje e tokave me vetërrjedhje nga uji që vjen me ngritje mekanike nga lumi Seman	600 lekë/dy per cdo ujitje	
16	Ujitje e tokave me ngritje mekanike nga vetëfermeri nga kanali kullues	400 lekë/dy per cdo ujitje	
17	Ujitje me system pikash në fushë të hapur	200 lekë/dy per cdo ujitje	
18	Ujitje e serave	Lekë/vit/dy	
19	Ujitje e serave për një periudhë 1 vjec	5000 lekë/dy per cdo ujitje	
20	Tarife per klorifikim per puset	200 leke /klorifikim	

Struktura përgjegjëse për vjeljen e tarifës :Drejtoria e shërbimeve publike dhe përcjell  
informacionin dhe llogaritjen e detyrimit tek Zyra e të Ardhurave.

Tarifat mbulohen nga subjekti që përfiton shërbimin.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës se shërbimeve është Zyra e të Ardhurave





### 11.9 Tarifa për kundërvajtje administrative.

Nr.	Shkelja e kryer	Masa e dënimit
1	Për dëmtim , çarje dhe ndotje rruge	20 000 lekë
2	Për dëmtim , çarje dhe ndotje tortuari	20 000 lekë
3	Për dëmtim 50 000 lekë plus	20 000lekë
4	Për dëmtim, bllokim pusete 50 000 lekë pus	20 000lekë
5	Për vjedhje te zgarës 50 000 lekë-m2	20 000lekë
6	Për vjedhje kapak pusete	20 000lekë
7	Lidhjet e pamiratuara në rrrjetin ajëror	20 000lekë
8	Dëmtimi I shtyllave të ndricuesve	20 000lekë
9	Dëmtimi i ndricuesve	20 000lekë
10	Përdorimi I shtyllave si support reklame	20 000lekë
11	Ndërhyrje në kuadrot e komandimit për ndriçimin publik	20 000lekë
12	Rehabilitimi I I ( nje )metër katror sipërfaqe bari tapet i dëmtuar	20 000lekë
13	Rehabilitimi I I ( nje )metër katror sipërfaqe lule sezonale	20 000lekë
14	Dëmtim i shkurreve dekorative	20 000lekë
15	Dëmtim I Pemëve	20 000lekë
16	Dëmtimi I koshave dhe kontienerve te plehrave dënohet me gjobe	20 000lekë
17	Për vendosjen e posterave pa leje në fasada, peme shtylla etj.	20 000lekë
18	Për cdo dëmtim të fasadës së qytetit	20 000lekë
19	Për zënien e rrugëve publike , rrugëve të parcelave, kanaleve të dyta dhe të treta	20 000lekë
20	Hedhja e mbeturinave, materialeve inerte jashtë vëndit të caktuar duke shkaktuar ndotje të ambientit apo bllokim të kanaleve	20 000lekë
21	Tarifë penalizuese per heqjen e kafshëve nga zona e banuar	10 000 leke

Qëllimi i sanksioneve të dëmtimeve të mësipërme është zhdëmtimi i pronës publike të dëmtuar dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve për respektimin e rregullit dhe lidhjet në jetën e përditshme në komunitet.

Konstatimi dhe shqyrtimi i shkeljes do të kryhet nga Policia Bashkiake dhe Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik vendor i Bashkisë Roskovec.



Ekzekutimi i vendimit do të kryhet nga sektori i Tatim – Taksave , Bashkia Roskovec.

**KRYETAR**

**Eleni Goga**



PAKETA FISKALE 2019



Nr. 4736/2 Prot.  
05.12.2018



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
PREFEKTI I QARKUT FIER

*Për bashkimin*  
*Ju e korrte*  
*sele e bashkuar*  
*06.11.2018*

Nr. 1953/2 Prot.

Fier, më 14.12.2018

**Lënda:** Kthim përgjigje për ligjshmërinë e vendimeve të Këshillit Bashkiak Roskovec.

**Drejtuar:** Znj. Majlinda BUFI  
Kryetare e Bashkisë Roskovec.

ROSKOVEC

**Për dijëni:** Znj. Eleni GOGA  
Kryetare e Këshillit Bashkiak Roskovec.

ROSKOVEC

Në përgjigje të shkresës tuaj me Nr.4736 Prot. Datë 22.11.2018, bazuar në Ligjin Nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" neni 16, shqyrtoam vendimin e Këshillit të Bashkisë Roskovec të datës 19.11.2018 si më poshtë vijon:

**Vendimi Nr. 93 datë 19.11.2018 i Këshillit Bashkiak Roskovec "Mbi miratimin e paketës fiskale për vitin 2019"** Eshtë në përputhje me Ligjin Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" nenet 9 dhe 54 shkronja "f" dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9632 Datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" (i ndryshuar) dhe në zbatim të Ligjit Nr. 10279 Datë 20.05.2010 "Për kundravajtjet administrative"; Ligjit Nr10463 Datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve". VKM Nr.129, Datë 18.03.1999, "Për procedurat dhe kushtet për dhënie e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, të gazit e të nënprodukteve të tyre" VKM Nr. 132 datë 07.03.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", me përjashtim të taksës së zënies së hapsirës e cila është shfuqizuar me Ligjin Nr. 9632 Datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" (i ndryshuar)

detyrimin të taksës”, me përjashtim të taksës së zënies së hapsirës e cila është shfuqizuar me Ligjin Nr. 9632 Datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar)

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Baki BALA

